



Npi – 01/115 datë: 28.03.2023

Bazuar në nenin 12.2 pika (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Nenin 10 dhe 11 të Ligjit për Tokën Bujqësore Nr.02/L-26; Nenin 6 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006 për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore; Planin Zhvillimor Komunal 2009-2020 Npi-01/264 dt.30.09.2009; Nenin 3.3 të Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, Npi – 01/77 datë: 28.03.2019; Pëlqimin për ndërrimin e destinimit të tokës, nga Ministria e Bujqësisë me numër të referencës ZSP-166/2024 të datës 29.02.2024, Kuvendi i Komunës, duke shqyrtuar propozimin e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Nr.02/188 të datës 18.03.2024, në seancën e mbajtur më 28.03.2024, miratoi këtë:

## V E N D I M

### **PËR DESTINIMIN E NGASTRËS KADASTRALE Nr. 313-1 PËR VARREZA TË FSHATIT DAVIDOC**

#### I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e -III- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më 28.03.2024, unanimisht, miratoi Vendimin për ndërrimin e destinimit të Ngastrës Kadastrale me numër P-72809023-00313-1 në Z.K-Davidoc, me sipërfaqe prej 17766m<sup>2</sup>, nga toka bujqësore në tokë jobujqësore, me qëllim të shfrytëzimit të parcelës për Varreza të komunitetit të fshatit Davidoc.

#### II

Ngastra Kadastrale me numër P-72809023-00313-1, ka sipërfaqe të përgjithshme prej 17766m<sup>2</sup>, (01h.77a.66m) e cila gjendet te vendi i quajtur “Utrinë”, Z.K-Davidoc, Shfrytëzimi aktual, Kultura/Kullosë e klasit të parë. Evidentuar Pronë e Komunës së Shtimes, e cila me këtë vendim destinohet sipërfaqe për Varreza të fshatit Davidoc.

#### III

A r s y e t i m: Kuvendi i Komunës, ka marrë parasysh edhe rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa Npi-01/108 dt. 26.03.2024 si dhe propozimin e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Nr.02/188 dt.18.03.2024 me arsyetimin se në këtë lokacion ka edhe varreza të mëhershme të fshatit, dhe nuk ka pengesa sipas Planit Zhvillimor të Komunës së Shtimes.

#### IV

Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, është e obliguar që të kryej procedurat tjera administrative dhe Ligjore për implementimin e këtij vendimi.

#### V

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokollit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

#### VI

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi Kuvendit  
Adnan Ademi